



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,27.05.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.05.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **Grup i Operatorëve Ekonomik Crazy Pet SH.P.K.; Blendi Bejdoni B.I.** ", per aktivitetin:" **Trajtimi i geneve endacak Nr. të Prok: 616 21 043 221 nxjerr:**

### V E N D I M

1.Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "" **Grup i Operatorëve Ekonomik Crazy Pet SH.P.K.; Blendi Bejdoni B.I.** ", per aktivitetin:" **Trajtimi i geneve endacak Nr. të Prok: 616 21 043 221** , kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit , të datës 23.03.2021 te publikuara ne web-faqe te KRPP-së.

2.Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit te Vendimit të AK-së të datës 24.05.2021.

3.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Operatori Ekonomik "Grup i Operatorëve Ekonomik Crazy Pet SH.P.K.; Blendi Bejdoni B.I., " me datë 25.05.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Trajtimi i qeneve endacak Nr. të Prok: 616 21 043 221**

Autoriteti Kontraktues, me datë 27.05.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi juaj se Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 1 te LPP-se dhe se nuk ka vepruar ne menyre transparente eshte plotesisht I pa bazuar,pasi qe çdo komunikim dhe shqetesim I shkruar nga tenderuesit eshte publikuar ne E prokurim;

-Pretendimi se eshte shkelur neni 7 poashtu nuk qendron pasiqe te gjithë tenderuesit jane trajtuar ne menyre te njejte dhe nuk eshte bere per asnje prej tyre asnje favorizim apo diskriminim;

-Pretendimi se jane ndryshuar kriteret e vleresimit poashtu nuk qendron sepse kriteri ka qene dhe ka mbetur çmimi me I lire,ndersa kerkesa qe eshte paraqitur ne FDT per veterinar te licencuar nuk paraqet asnje lloj diskriminimi,por eshte marre si formulim nga Udhezimi Administrativ;

-Pretendimi tjetër poashtu nuk qendron pasi qe Autoriteti Kontraktues nuk ka kerkuar sigurim te deshmive bankare dhe ua perkujtojmë se vleresimi I tendereve sipas te gjitha dispozitave ligjore duhet te behet sipas kerkesave ne Dosjen e tenderit dhe nuk guxojne te shtohen kriterë tjerë per vleresim;

-Pretendimi per mosrespektim te nenit 72 poashtu eshte I pa bazuar,pasi qe AK-ja mund te kerkoj sqarime per mangesite eventuale ne dokumentacionin e derguar ne oferte dhe ne harmoni me nenin 39.8 te RRUOPP-se e qe nje suate e tille nuk ka ekzistuar te tenderi juaj;dhe

-Poashtu pretendimi per ndryshim te kerkesave ne kundërshtim me nenin41.1 te RRUOPP-se nuk eshte I bazuar sepse ne asnje rast nuk ka asnje ndryshim te ndaluar,pasi qe nga Organi Kompetent per licencim AVUK jemi njoftuar se ky organ nuk leshon licenca per veterinary,por ne baze te kualifikimit te tyre leshon licenca per OE-ik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit